



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT
DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

**PROCESVERBAL
PËR HARTIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE PËRLLOGARITJEN E
FONDIT LIMIT PËR PROCEDURËN E PROKURIMIT “SIGURIMI I SHËNDETIT
DHE PASURISË”**

I mbajtur në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit, për procedurën e prokurimit publik me objekt: *“Sigurimi i shëndetit për gjyqtarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, personat e lidhur të gjyqtarëve, këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor, Sekretarin e Përgjithshëm, Drejtorët e Drejtorive, stafin administrativ dhe sigurimi i pasurisë”*.

Në zbatim të nenit 25 të ligjit nr. 84/2016 *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, vendimit nr. 35/2022, të Kuvendit të Shqipërisë, të nenit 49 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, *“Për Prokurimin Publik”*, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, *“Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”*, i ndryshuar, VKM-së nr. 457, datë 26.07.2023, *“Për disa ndryshime në vendimin nr. 132, datë 07.03.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”*, të ndryshuar, të vendimit të Mbledhjes së Gjyqtarëve nr. 2, datë 09.01.2024, *“Për miratimin e detajimit të fondeve buxhetore për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit për vitin 2024”*, Grupi i Punës pas testimit të tregut, hartoi specifikimet teknike duke pasur parasysh kriteret si më poshtë:

- *Sigurim vjetor i shëndetit për 7 (shtatë) gjyqtarë me vlerë mbulimi 20,000,000 (njëzet milionë) lekë për person. Zona e mbulimit për sigurimin e shëndetit, për gjyqtarët, e hartuar në këto specifikime, është caktuar Republika e Shqipërisë dhe Evropa.*
- *Sigurim vjetor i shëndetit për personat lidhur të gjyqtarëve, këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor, Sekretarin e Përgjithshëm dhe Drejtorët e Drejtorive 43 (dyzet e tre) persona, me vlerë mbulimi 4,000,000 (katër milionë) lekë për secilin për person. Zona e mbulimit për sigurimin e shëndetit, për personat lidhur të gjyqtarëve, këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor, Sekretarin e Përgjithshëm dhe Drejtorët e Drejtorive, e hartuar në këto specifikime, është caktuar Republika e Shqipërisë dhe Evropa.*
- *Sigurim vjetor i shëndetit për stafin administrativ 28 (njëzet e tetë) persona me vlerë mbulimi 600,000 (gjashtëqind mijë) lekë për person. Zona e mbulimit për sigurimin e shëndetit, për stafin administrativ, e hartuar në këto specifikime, është caktuar Republika e Shqipërisë.*
- *Sigurim vjetor i pasurisë për 1 (një) gjyqtar nga aktet keqdashëse në masën 9,267,370 (nëntë milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e treqind e shtatëdhjetë), ku përfshihet:*

- a) *sigurimi i banesës*, në vlerën 7,207,370 (shtatë milion e dyqind e shtatë mijë e treqind e shtatëdhjetë), vlerë e cila është llogaritur duke u bazuar në kostot e ndërtimit të përcaktuar në VKM-në nr. 457, datë 26.07.2023, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 132, datë 07.03.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”, të ndryshuar.
- b) *sigurimi i mobilimit*, si pjesë e banesës në vlerën 2,060,000 (dy milion e gjashtëdhjetë mijë), sipas vetëdeklarimit.
- *Monedha e përdorur*. Në hartimin e specifikimeve dhe llogaritjen e përfitimeve për të gjitha kategoritë e sigurimit është përdorur monedha Lek (ALL), në përputhje me monedhën në të cilën operon buxheti i Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Në përcaktimin e elementëve përfitues të sigurimit të shëndetit, Grupi i punës u mbështet në kushtet e tregut shqiptar të shoqërive të sigurimeve. Në përcaktimin e këtyre elementëve, Grupi i punës përzgjedhi elementët më të domosdoshëm për përfitimin nga sigurimi i shëndetit. Meqenëse shoqëritë e sigurimit që operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë mbulojnë rrjetin spitalor jopublik brenda territorit dhe një rrjet spitalesh dhe klinikash në Evropë, zona e mbulimit për sigurimin e shëndetit, e hartuar në këto specifikime, është caktuar: Republika e Shqipërisë dhe Evropa për gjyqtarët, personat lidhur të gjyqtarëve, këshilltarët e Njësisë së Shërbimit Ligjor, Sekretarin e Përgjithshëm dhe Drejtorët e Drejtorive dhe Republika e Shqipërisë për stafin administrativ.

Në vijim, Grupi i punës ka paraqitur paketën e hartuar, si dhe mbulimet për të gjithë elementët, ku përfshihet sigurimi i shëndetit për gjyqtarët, sigurimi i shëndetit për personat e lidhur të gjyqtarëve, këshilltarët e Njësisë së Shërbimit Ligjor, Sekretarin e Përgjithshëm dhe Drejtorët e Drejtorive, stafin administrativ dhe sigurimi i pasurisë.

“Sigurimi i shëndetit për gjyqtarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, personat e lidhur të gjyqtarëve, këshilltarët e Njësisë së Shërbimit Ligjor, Sekretarin e Përgjithshëm, Drejtorët e Drejtorive, stafin administrativ dhe sigurimi i pasurisë”

Nr.	Përshkrimi	Nr. personave të siguruar	Vlera e mbulimit /person (në lekë)
1.	Sigurim i shëndetit për gjyqtarët	7 (shtatë)	20,000,000
2.	Sigurim i shëndetit për personat e lidhur të gjyqtarëve, këshilltarët e Njësisë së Shërbimit Ligjor, Sekretarin e Përgjithshëm dhe Drejtorët e Drejtorive	43 (dyzet e tre)	4,000,000
3.	Sigurim i shëndetit për stafin administrativ	28 (njëzet e tetë)	600,000
4.	Sigurim i një apartamenti në Tiranë, me sipërfaqe 84,1 m ²		9,267,370

I - SIGURIMI I SHËNDETIT PËR GJYQTARËT E KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT

TABELA E PËRFITIMEVE

I. SIGURIMI I SHËNDETIT	
Përfitimi maksimal vjetor për person	20,000,000 lekë

Zona e mbulimit në sigurim	Shqipëri, Evropë
TRAJTIM I TË GJITHA GJËNDJEVE SHËNDETËSORE EKZISTUESE OSE JO	
1- Përfitime për trajtim si pacient i shtruar në spital jo-publik (sëmundje apo aksident)	
Dhoma në spital (dhomë private)	
Transporti për trajtim jashtë Shqipërisë	100% deri në 60,000 lekë
Shpenzimet për mjekët specialiste, kirurgët, anesteziat	100%
Shpenzime për materialet dhe qiraja e dhomës së operacionit	100%
Kujdesi intensiv (reanimacion)	100%
Ilaçet dhe medikamentet mjekësore për përdorim në spital, si dhe gjaku plazma dhe oksigjeni	100%
Kontrolle diagnostikuese, duke përfshirë ato patologjike, rreze X, skane CT, skane MRI, skane PET	100%
Radioterapi dhe Kimioterapi	100%
Proteza dhe pajisje mjekësore të ngjashme	100%
Tranplanti i organeve	100%
Shpenzime për strehimin e një prindi që shoqëron një të mitur nën 16 vjeç	Max 5,000 lekë/dita
Akomodim dhe ushqim	100%
2- Përfitime pa shtrim (klinikë mjekësore apo spital jo-publik)	
Shpenzimet për vizitë te mjeku specialist	100%, max 500,000 lekë për të gjitha shpenzimet së bashku
Teste diagnostikuese, përfshirë X-Ray, CT Scan, MRI, PET Scan dhe ekzaminime të rekomanduara nga një mjek	
Fizioterapi	
Ilaçe të rekomanduara nga mjeku	Max 250,000 lek
Terapi mbështetëse (akupunktura, honopati, osteopati, kiroprakti)	Max 45,000 lek
Radioterapi dhe Kemioterapi	100%
Ndërhyrje kirurgjikale pa shtrim	100%
3- Përfitime të tjera	
Transporti me ambulancë rrugore	100%
Evakuim mjekësor me ambulancë ajrore (helikopter, avion) në rast emergjence që kërcënon jetën	Deri në 1,800,000 lekë
Përfitime të tjera shpenzimesh dentare Trajtim dentar emergjent Trajtim dentar, mbushje, heqje, ura, si dhe emergjenca dentare, impiante, proteza. Kujdesi parandalues – check up	Max 100,000 lekë
Përfitime të tjera në rast shpenzimesh për pajisje të jashtme Kujdesi për shikimin/1 pale xhama syzesh ose lente/vit ose korrektim i numrit Kujdesi për dëgjimin. Një aparat për secilin vesh çdo tre vjet Kujdes ortopedik, aparate të drejtimit të shtyllës kurrizore në rast skolioze	20,000 lekë në vit për të gjitha këto shërbime së bashku

Shërbimi për gjetjen e mjekut për çdo rast	100%
II. SHËNDETI NË UDHËTIM	
Zona e mbulimit në sigurim Sipas përqindjes së përcaktuar nga PSSHU	Në të gjithë botën
Shpenzimet për emergjencat mjekësore	1,250,000 lekë
III. PËRFITIME PËR PA AFTËSI	
Përfitimi për pa aftësi të përhershme të plotë për shkak aksidenti dhe akte të dhunshme	20,000,000 lekë
Përfitimi për pa aftësi të përhershme të pjesshme për shkak aksidenti dhe akte të dhunshme	në % sipas shkallës së dëmtimit

Paketa e parë përfshin trupën e gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, të përbërë nga 7 (shtatë) persona, të grup moshave si më poshtë:

Deri në 30 vjeç	__ persona;
31 - 40 vjeç	__ persona;
41 - 50 vjeç	__ persona;
Mbi 51 vjeç	7 (shtatë) persona.

II - SIGURIMI I SHËNDETTIT PËR PERSONAT E LIDHUR TË GJYQTARËVE, KËSHILLTARËT E NJËSISË SË SHËRBIMIT LIGJOR, SEKRETARIN E PËRGJITHSHËM DHE DREJTORËT E DREJTORIVE
TABELA E PËRFITIMEVE

I. SIGURIMI I SHËNDETTIT	
Përfitimi maksimal vjetor për person	4,000,000 lekë
Zona e Mbulimit	Shqipëri, Europë
1- Përfitime ne rast shtrimi në spital jo publik	
Dhoma në spital (dhomë dyshe)	
Akomodim dhe ushqim	100%
Shpenzimet për kirurgët, mjekët, specialistët, dhe anesteziat	100%
Shpenzimet për materialet dhe qiraja e dhomës së operimit	
Kujdesi intensiv (reanimacion)	100 %
Kontrolle diagnostikuese, duke përfshirë ato patologjike, rreze X, skane CT, skane MRI, skane PET	100 %
Ilaçet dhe medikamentet mjekësore për përdorim në spital, si dhe gjaku plazma dhe oksigjeni	100 %
Transporti për në klinikë	100 %
2- Përfitime për trajtim ditor (pa shtrim në spital)	
Vizita te mjeku (shpenzime për mjekun e përgjithshëm, mjekun specialist)	Maksimumi 200,000 lekë në vit, për të gjitha shpenzimet së bashku
Kujdesi parandalues (Check up një herë në vit)	15,000 lekë/vit
Kontrolle diagnostikuese, duke përfshirë ato patologjike, rreze X, skane CT, skane MRI, skane PET	100 %
Radioterapi dhe Kemioterapi	100%
Ndërhyrje kirurgjikale pa shtrim	100%
Receta mjekësore	deri në 30,000 lekë/vit
3- Përfitime të tjera	
Riatdhesim, evakuim mjekësor (përfshirë ambulancë ajrore të	deri në 1,500,000

specializuar)	
Shërbimi i ambulancës në rrugë	100%
Shpenzime emergjenca dentare	deri në 30,000 lekë
Kujdes për shikimin	
Kujdes për dëgjimin	
Kujdes ortopedik	
II. SIGURIMI SHËNDETIT NË UDHËTIM	
Zona e Mbulimit	Zona A dhe B
Ndihmë shëndetësore	500,000 lekë
Shpenzime për riatdhesim	1,000,000 lekë
III. PËRFITIME PËR PA AFTËSI	
Përfitimi për pa aftësi të përhershme të plotë për shkak aksidenti dhe akte të dhunshme	4,000,000 lekë
Përfitimi për pa aftësi të përhershme të pjesshme për shkak aksidenti dhe akte të dhunshme	në % sipas shkallës së dëmtimit

Paketa e dytë (e përmbledhur) përfshin personat e lidhur të gjyqtarëve dhe një pjesë të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, të përbërë nga 43 (dyzet e tre) persona të grup moshave si më poshtë:

Deri në 30 vjeç	9 (nëntë) persona;
31 - 40 vjeç	7 (shtatë) persona;
41 - 50 vjeç	17 (shtatëmbëdhjetë) persona;
Mbi 51 vjeç	10 (dhjetë) persona.

III - SIGURIMI I SHËNDETIT PËR STAFIN ADMINISTRATIV

TABELA E PËRFITIMEVE

I. SIGURIMI I SHËNDETIT	
Përfitimi maksimal vjetor për person	600,000 lekë
Zona e Mbulimit	Shqipëri
1- Përfitime ne rast shtrimi në spital në rast sëmundje apo aksidenti	
Dhoma në spital (Dhomë dyshe)	100 % deri në 120,000 lekë dhe 70 % mbi 120,000 lekë
Akomodim dhe ushqim	
Shpenzimet për kirurgët, mjekët, specialistët, dhe anezistët	
Shpenzimet për materialet dhe qiraja e dhomës së operimit	
Kujdesi intensiv (reanimacion)	
Kontrolle diagnostikuese, duke përfshirë ato patologjike, rreze X, skane CT, skane MRI, skane PET	
Fizioterapi	
Radioterapi dhe kemioterapi	
Ilaçet dhe medikamentet e këshilluara nga mjeku	
Proteza dhe pajisje mjekësore të ngjashme	
Trajtim në rast shtrimi në spital publik (vetëm në rast ndërhyrje kirurgjikale)	120,000 lekë
2- Përfitime për trajtim ditor (pa shtrim në spital) në rast sëmundje apo aksidenti	
Nën limit vjetor	180,000 lekë
Shpenzime për mjekun e përgjithshëm	100%

Shpenzime për mjekun specialist dhe ekzaminime të rekomanduara	100%
Kujdesi parandalues (check up)	7,000 lekë
Fizioterapi	10 seanca
Kontrolle diagnostikuese, duke përfshirë ato patologjike, rreze X, skane CT, skane MRI, skane PET	100 %
Kirurgjia ditore	100%
3- Përfitime të tjera	
Shërbimi i ambulancës në rrugë	100%

Paketa e tretë (e përmblodhur) përfshin një pjesë të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, të përbërë nga 28 (njëzet e tetë) persona të grup moshave si më poshtë:

Deri në 30 vjeç	5 (pesë) persona;
31 - 40 vjeç	11 (njëmbëdhjetë) persona;
41 - 50 vjeç	7 (shtatë) persona;
Mbi 51 vjeç	5 (pesë) persona.

IV - SIGURIMI I PASURISË

- Të dhënat për banesat që do të sigurohen

Nr.	Përshkrimi	Qyteti	Sip.m ²	Vlera e apartamentit (VKM nr. 457, datë 26.07.2023) 85,700 leke/m ²	Shpenzime për mobilim dhe orendi (vlera në lekë)	Vlera totale (në lekë)
1	Prona 1	Tiranë	84.1	7,207,370	2,060,000	9,267,370

Sigurimi i banesës dhe i mobilimit do të bëhet nga dëmtimet si pasojë e akteve keqdashëse për shkak të detyrës.